



Republika e Kosovës
Republika Kosova –
Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality
of Prishtina



Datë/a:	11.04.2019
Për/ Za/ To:	N.P.T. Artani
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 08.04.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “N.T.P. Artani”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për Biblioteken Hivzi Sylejmani”, me Nr. të Prok: 616 19 963 121 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “N.T.P. Artani” të dt. 08.04.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me libra për Biblioteken Hivzi Sylejmani”, me Nr. 616 19 963 121, kundër Vendimit të AK –së, të datës 03.04.2019.**
2. **Mbetet në fuqi vendimi i AK datë: 03.04.2019.**
3. **Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me libra për Biblioteken Hivzi Sylejmani”, me Nr. 616 19 963 121 të vazhdojë me vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit.**
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 11.03.2019 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me libra per Bibloteken Hivzi Sylejmani”**, me Nr. **616 19 963 121**, procedura e hapur.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është parapare me datë 03.04.2019. Ne po te njëjtën dite, AK është njoftuar nga një OE ne lidhje me gabimin qe është paraqitur ne lidhje me afatin e fundit (kohen) e dorëzimit te ofertave, ne vend te orës 13:30 është shënuar 01:30. **Dëshmi : emaili i OE**

Duke pare ketë gabim teknik dhe pamundësisë se shtyrjes se afatit sepse tashme çdo gjë kishte përfunduar (kishte skaduar afati i fundit te dorëzimit te ofertave pas mesnatës) Autoriteti Kontraktues për te respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik ka vendosur qe te anuloj aktivitetin e prokurimit, ne pamundësi te korrigjimit te situatës se krijuar.

Me datë 03.04.2019, Autoriteti Kontraktues ka ngritur Njoftimin për Vendimin e AK.

OE “N.T.P. Aratni”, me dt. 08.04.2019, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/ A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me libra per Bibloteken Hivzi Sylejmani”**, me Nr. **616 19 963 121**, kundër vendimit te AK, në të cilin theksohet se AK ka **shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:**

Neni 1: Qëllimi

Neni 7: Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 58: Hapja e tenderëve

Neni 108/ A: Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjes

I. Baza ligjore

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon OE “N.P.T. Artani”, Autoriteti Kontraktues sqaron se ka vepruar ne përputhje te plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. **Neni 1: Qëllimi** - sipas këtij neni qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. AK e ka respektuar ketë nen duke anuluar aktivitetin e prokurimit ne mënyre qe te siguroj

mënyrën me efikase dhe me transparente të shfrytëzimit të fondeve publike dhe nuk sheh këtu asnjë element për shkelje të këtij neni.

2. **Neni 7: Barazia në trajtim/Jo-Diskriminimi** - sipas këtij neni AK është i obliguar që do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, gjë të cilën AK e ka respektuar, duke trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë, pasi që për gabimin e vet AK ka anuluar aktivitetin në mënyrë që t'iu epet mundësia të gjithë OE të konkurrojnë dhe nuk sheh këtu asnjë element për shkelje të këtij neni.

3. **Neni 58 "Hapja e tenderëve"** - sipas këtij neni AK është i obliguar që të gjithë tenderët që dorëzohen para afatit të fundit kohor për dorëzimin e tenderëve do të hapen në vendin dhe **kohën e specifikuar**.
 - ✓ Për shkak të gabimit teknik tenderët **nuk kanë pasur mundësi të hapen në kohën e specifikuar (pas mesnatës)**;
 - ✓ Meqenëse gabimi është vërejtur në ditën e fundit, pas saktimit të afatit të fundit për dorëzim të ofertave dhe kjo vetëm pas njoftimit të këtij gabimi nga një OE nuk ka pasur **mundësi të korrigjimit të situatës**.

AK në mënyrë që të veproj në përputhje me dispozitat e LPP

- ✓ **nenin 58 "Hapja e tenderëve"** - të gjithë tenderët që dorëzohen para afatit të fundit kohor për dorëzimin e tenderëve do të hapen në vendin dhe **kohën e specifikuar**; dhe
- ✓ **nenin 5 "Kalkulimi i afateve kohore"** - Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Shehide Jashari

From: Office1 Kosova <office1kosova@hotmail.com>
Sent: 03 April, 2019 10:39
To: Info Krpp; Eprokurimi Helpdesk; Monitorimi Krpp; Shehide Jashari; Prokurimi Prishtine
Subject: kerkes per shtyrje te afatit te dorezimit te ofertave
Attachments: Mos hapja e dorezimit te tenderit.png

Te nderuar,

Ju informoi qe AK Komuna e Prishtines ka caktuar dorezim te tendereve Furnizimi me libra për Bibliotekën Hivzi Sylejmani Nr i prokurimit 616-19-963-1-2-1
Nr i brendshëm 616 19 021 121 ne kundërshtim me LPP-ne ne ora 1;30 te mengjesit, ju lutemi qe aktivitetin ne fjale ta shtyeni per nje dite tjeter dhe te ndermerrni masa qe nje gje e till te mos perseritet, si pasoje e ketij leshimi neve na pamundesohet pjesmarrja dhe dorezimi i ofertes.

Me respekt / Best Regards,

Hasan Gigollaj

"Office 1 Kosova" shpk
mob: +383 49 573 573
st: Besim Shala n.n. - Prizren 20 000
st: Nena Terezë nr. 497 - Prishtine/Fushe Kosove 10 000



facebook page: 

Regullativ i Prokurimit Publik



LEGJISLACIONI



MANUALET



INFORMACIONE



TRAJINIMET



RAPORTET



KONTAKTET

Shqip



AGIM MURATI



Kërko

Oferat

Ofertuesi	Prokurimi	Autoriteti kontraktues	Lënda e ofertës	Kodi	Afati për dorëzimin e ofertave	Data e pranimit
<input type="checkbox"/> "OFFICE 1 KOSOVA" SH.P.K	Furnizimi me libra për Bibliotekën Hivzi Sylejmani	KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES	616-19-963-1-2-1	616-19-963-1-2-1	03.04.2019 01:30:00	
<input type="checkbox"/> "OFFICE 1 KOSOVA" SH.P.K	Furnizim me materiale te ndryshme zyrtare- Niveli qendror	Agjencia Qendrore e Prokurimit	UA/2016-18-9645-1-1-1 për pjesë - 2,4;	AQP 18 006 111	19.03.2019 13:30:00	19.03.2019 12:00
<input type="checkbox"/> "OFFICE 1 KOSOVA" SH.P.K	Furnizim me tonera për te gjitha njesit shpenzuese në Komunën e Gjilanit	KUVENDI KOMUNAL- GJILAN	651-18-2170-1-2-1	2018/12	10.04.2018 14:00:00	
<input type="checkbox"/> "OFFICE 1 KOSOVA" SH.P.K	Shtypja dhe furnizimi me formular të QMF-s dhe administratës	KOMUNA E MAMUSHES	626-18-680-2-3-6	220218	28.02.2018 14:00:00	
<input type="checkbox"/> "OFFICE 1 KOSOVA" SH.P.K	Furnizimi me materialin per zyre	KOMUNA RANILLUG	661-18-685-1-3-6	230218	23.02.2018 12:00:00	22.02.2018 18:20
<input type="checkbox"/> "OFFICE 1 KOSOVA" SH.P.K	Furnizimi me material te shtypur për gjykata dhe KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	328-17-5463-1-1-1	2908	31.01.2018 14:30:00	
<input type="checkbox"/> "OFFICE 1 KOSOVA" SH.P.K	Furnizim me pasisje muzikore per kabinete te muzikes	KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES	616-17-4281-1-2-1	123123	29.09.2017 13:30:00	

Numri i pergjithshem te dhenave te

Detajet

Tërheqë

Reminder

Afati për dergimin e tenderit nuk ka kalu, oferta është e krijueme Afati për dergimin i tenderit nuk ka kalu Afati për dergimin i tenderit ka kalu